



Kjo gazetë ju sjell lajmet dhe informacionet e fundit rreth projektit ‘Heritage is Our Brand’, financiar nga Bashkimi Europian, zbatuar nga DMO Albania/EU Policy Hub.

Heritage is Our Brand

Heritage is our brand, është një projekt që synon të ndërgjegjësojë të rinjtë tanë për të njohur dhe ruajtur trashëgiminë shpirtërore. Më shumë rreth projektit [këtu](#)



Prezantimi publik i Projektit



Më datën 6 mars 2025 në mjediset e Hotel Tirana International, u prezantua projekti “Heritage is our brand”, “Trashëgimia është marka jonë”. Të pranishëm ishin përfaqësues nga Delegacioni i Bashkimit Europian ne Shqiperi, perfaqesues nga Ministria e Ekonomise, Kultures dhe Inovacionit, perfaqesues nga Akademia e Shkencave dhe nje numer i madh studiuesish, arkeologesh, historianesh, artiste, perfaqesues te shoqatave kulturore dhe mediave. [Më shumë](#)

Pyetsor për trashëgiminë jomateriale

Mbi 1,000 të rinj u pyetën rreth trashëgimisë jomateriale, njohurive që kishin marrë në shkollë, në komunitet si dhe në familje. Ky ishte pyetsori i parë mbarëkombëtar i dedikuar enkas për trashëgiminë shpirtërore. Rezultatet ishin shumë interesante dhe i gjeni [këtu](#)



Studimi historik




Nga Mbretëresha Teuta te Nënë Tereza, nga qytetërimi ilir deri në kohët moderne, 40 histori unike janë identifikuar nga një grup pune ekspertësh të historisë, arkeologjisë dhe trashëgimisë dhe janë sjellë në një formë unike për të gjithë grupmoshat
Shihni historite [këtu](#)

Thirrje për ide

Projekti “Heritage is Our Brand”, shpall thirrjen për aplikime për skemën e granteve të vogla. Kjo thirrje për aplikime fton nisma krijuese dhe kulturore, që shndërrojnë trashëgiminë kulturore jomateriale në shprehje artistike dhe vizuale duke përdorur metoda bashkekohore. Më shumë rreth dokumenteve të aplikimit klikoni [këtu](#):
Afati 15 Tetor



Platforma edukative Albania-Heritage



Pse një platformë e këtij lloji? Sepse nuk ka një platformë ku historia jonë materiale dhe jo materiale të jetë pasuruar me storytelling për të gjitha moshat dhe grupet e interesit. Platforma përfshin jo vetëm 40 histori që do vazhdojnë të shtohen me qindra, por dhe një fushatë edukuese që këto histori të përcillen te brezat e rinj.

Rreth nesh

DMO Albania dhe EU Policy Hub realizojnë së bashku për herë të parë një bashkëpunim ku kanë bashkuar ekspertizat respektive në trashëgiminë kulturore, turizmin e qëndrueshëm dhe përafrimit të Shqipërisë me këta sektorë drejt Bashkimit Europian.



Na ndiqni në rrjetet sociale për më shumë informacione

